



PROCESVERBAL IV/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së V (pestë) për vitin 2025 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.05.2025
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin vlerës së bonus banimit;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-18942;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesa 01-Nr-553-27510;**

Kryesuesi- Përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës. E hedh në votim rendin e ditës:

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 1

Unanimisht miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fondaj-Përshendetë të pranishmit.Te kjo projekt-rrregullore jam nal tek disa pika që du me I permendë këtu, e para është një proces jo transparent dhe përjashtues,ky dokument nuk ka kalu në process gjithëpërfshirës,nuk është njoftu as në Asamble as Komisionet përkatëse nuk jan marr për bazë në këtë projekt-rregullore.Por ni mungesë të paqartësis formulimet jan të paqarta dhe të hapura dhe një interpretim të rrezikshëm që rrezikon të krijojnë favore për investitor të caktuar.Nuk e kan bë një analizë të ndikimit infrastrukturor dhe buxhetit ,nuk ka asnje vlerësim të ndikimit në rrjetin infrastrukturor,shërbime publike ose financa.Nuk është e qartë saktë me këtë projekt-rregullore se çka po përfiton ose humb Komuna.Kjo projekt-rregullore i jep të drejtë veq Kryetarit të Komunës me formu Komisionin.Nëse kjo projekt-rregullore është bër për Ekzekutivin,ni vendim vendos Ekzekutivi jo me na sjell neve në Asamble edhe me kalu qysh po doni ju.Si përfundim unë kërkoj që kjo projekt-rregullore të hiqet dhe të rishikohet edhe një here dhe të jetë më transparent për gjithë përfshirësit me ekspertë të fushës përkatëse,shoqëris civile dhe aspektit politik.

Urim Suka-Përshendetë të pranishmit.Unë I bashkangjitëm secilës fjalë të Liridonit,janë mendimet e njëjta ,nuk kemi pas as informatë më të vogël për hartimin dhe miratimin e një rregullore të tillë,në parim ne jemi për ndoshta që Komuna me pas një rregullore,por tek trasnparenca un jam duke u mundu sot me e lexu në tërsi rregulloren ,un ,unë nuk jam fare ekspert I fushës për të cilën po flasim por gjatë leximit nuk

e kuptova,as cili është interesi publik që mbrohet nga kjo rregullore,as cili është qëllimi pse po e hartojmë këtë rregullore,as kush janë përfitues.Në disa pika kërkohej që vlerësimin e këtyrre aplikimeve e bën Komuna dhe nuk kishte as kritere,veç 25% është vlerësimi maksimal po as I kujt për mu ishte krejtë e paqartë.Tu i marrë krejtë për bazë këto kisha pas dëshirë ata që e kan shty deri këtu Drejtori apo dikush dikush nga komisioni që e kan hartu këtë rregullore me na dhën informacione shtesë .Gjatë leximit kam kuptu dmth kjo rregullore mbi hartat Zonale jep disa të drejta nëse dikush e sjellë një projekt të hartum,përmbi harta Zonale i lejohet diqka aty.Dhe për me u lidhë më shumë me atë qka tha Liridoni,tek neni 16 dikun mu duk me një far forme si një përgaditje tereni për dikan,për me përfitu dikush.Psh. te neni 16 në hyrje fuqi të kësaj rregullore të gjitha objektet që jan të paisur me leje ndërtimi sipas hartave zonale të Komunës konkretish prej hyrjes në fuqi të hartave zonale të cilat nuk kan përfunduar ndërtimin ju lejohet ti shfrytëzojnë bonuset e zotimit dmth prej kur I kemi hartat Zonale para dy viteve nëse nuk ka përfundu ai ndërtimi ai mundet prap me apliku që ky pragraf mu më la me kuptu që kjo rregullore ndoshta po përshtatet për qëllime të caktume për dikan që me e shfrytzu dhe përfitu prej ksaj rregullore.Nëse mundet dikush mema interpret cili është qëllimi I kësaj rregullore? Cila është fushëveprimtaria më e saktë,Kush jan përfituesit dhe Cfarë përfiton interesi piblik me miratimin e kësaj rregullore?.Fillimisht un jam me mendimin e Liridonit që kjo rregullore me u kthy në pikën 0 dhe me fillu me u interpretu prej fillimit.Dhe një pyetje tjetër që unë po du me e ditë rregullore të tillë a ka pas komuna jonë më here apo është një draftim I ri për here të par që po vjen.

Dardan Berisha –Përshendetë të pranishmit,realisht qfar do rregullore që vjen ne si Kuvend duhet me miratu e kemi obligim qoftë për bursa qoftë për drejtori dhe digastere të ndryshme.Është mëse e vërtetë a kemi pas të drejtë edhe ne qasje në këtë rregullore të subjekteve politike,këtë besoj edhe Drejtori na tregon që a ka pas thirrje publike në lidhje me rregulloren dhe që është tu hartu një rregullore e tille fillimisht të njoftohemi në detaje.Sa i përket votimit të rregullores ne e kemi votu qdo rregullore edhe pse nuk kemi marrë pjesë në hartimin e asaj rregullore na e kemi obligim si Kuvend me e miratu në Kuvend sepse kjo duhet me marr miratimin e Kuvendit ,ligjshmeri të Kuvendit.

Liridon Fondaj-Dardan pajtohem un që në kemi miratu rregullore,port e paktën do Komisione jan shpërnda në subjekte politike,kjo rregullore për formimin e Komisionit po ja jep të drejtën veq Kryetarit.

Visar Kuqi-Me kërkes të Drejtorisë sonë,me vendim të Kryetarit është caktu Komisioni dhe ekipi punues,në ekip punues kan marrë pjesë nga të gjitha fushat,duke përfshi prej zyrës ligjore,zyra e kadastër.Po lidhem tek Liridoni që mos ka pas diqka politike,un jam mundu mos me e fut asnje Drejtor këtu.Si rregullore ju tham me shum përgjegjësi që jemi vonu pak,kemi punu gjatë me zyrtaret e urbanizmit,unë dheAvnia kemi mbajtë 7-8 takime.Deri tash nuk ka asnje Komun te aprovun.

Kjo rregullore ka me i lehtësu shumë sene Komunës,nuk kan me përfitu investitorë.

Liridon Fondaj –Konsultimi public ka mund me kan me i hershem,me 5 e ke shpall publikisht dhe neve na vjen me 22 rregullorja.

Visar Kuqi-une dhe Avnia kemi qen fizikisht ne Ministri dhe i kemi mbajt konsultimet.Tek pjesa e degjimit public pjesen ligjor e kemi respektu,ka qenë 15 ditë.

Urim Suka-qekjo rregullore për me qene më I kjart,hartat zonale jan te miratume dhe kjo rregullore del përmbi harta zonale dhe krijonn hapsira me shume për ndërtim qoftë për hapsira tjera deri në 25%.

Saniqe Kuqi Rexhepaj-nëse I ki 10 ari po supozojmë që interesi është për rrugë,meren më shumse 250m nuk kompenzon se nuk ke ku me i qu.

Avni Bytyqi—Bazën ligjore e ka te udhezimi administriv 2024-2015 për hartat zonale,fatmirsisht kur eshte miratu ne e kemi parapa që Komuna mundet me nxerr rregullore ,jemi duke punu që 1 vit dhe kemi ardh në përfundim që këtë muaj ta qesim në Kuvend për miratim, dhe besoj që I kemi shterrë të gjitha procedurat ligjore që kërkohej.Urim edhe un e kam pas këtë shqetësim edhe pse kam qenë grup punues sepse qeshtjete urbanistikes un nuk I kuptoj. Në aspektin tim professional,të Drejtorit dhe ekipit punues I kemi sqaru por megjithatë mbetet pak në përgjegjësin e Ministrisë që të jep verdiktin final që a e ka konfirmimin e Qeverisë kjo rregullore që pavarsisht a miratohet në Kuvend prap po ju them që nuk ju garantoj që kjo rregullore e merr konfirmimin e ligjshmërisë prej Ministrisë.Kjo rregullore ka kuptim vetëm atëher kur Komuna ka interes dhe biznesi afarist ka interes me hy në procedur të bonus banimit për rregullimin e infrastrukturës rrugore,shesheve,parqeve,lëvizjes së lire të këmbësorëve.Nëse Komuna e

shih të arsyeshme, e me të një veprim të tillë, hynë lexone arsyen pse nuk është përfshi legjislativi se është dashtë legjislativi me nxerrë akte për të cilat Ekzekutivi I ka për obligim mi ekzekutu ashtu siq miratohen në legjislativ. Edhe te Komisioni në kemi bashkëpunu edhe me Ministrinë dhe e kemi pa më të arsyeshme të jetë ekzkluzivisht prej ekzekutivit që në fund her do kur kërkohet nga legjislativi për me raportu për një veprim të veprim të tillë Ekzekutivi e ka për obligim me raportu. Unë kam insistu me qenë një ekspert nga jashtë që është ekspert I licencum me ba vlerësimin e pronës, sepse vlerësimin ka drejtë ta bëjë vetem eksperti I licencum, asnjë zyrtar as një ekspert që nuk është I licencum nga Ministria e planifikimit hapsinor. Deri sot asnjë Komunës nuk I ka kalu.

Liridon Fondaj-Qekjo projekt-rregullore Zyrtar Ligjor mosi është konsultim publik a do të duhet neve si Asambleist me na ardhë në email dhe ne për këtë kohë me I dhën vrejtitet dhe sugjerimet tona.

Avni Bytyqi-jo nuk kemi obligim, obligim ligjor është me publiku në tabelat e shpalljeve dhe në websiten e Komunës. Unë po mendojë që nga aspekti ligjor jemi në rregull për arsye se e kemi publiku. Deri ditën kur nuk miratohet nga Kuvendi qdo koment qdo sugjerim, qdo rekomandim që na vjen ne e kemi për obligim ta inkurperohemi nëse e shohim të arsyeshme dhe të domosdoshme, pa marrëparasysh a është në procedur të miratimit qdo koment është i mirëseardhur.

Sanije Kuqi Rexhepaj-Përshendetje për të gjithë, po rregullorja e bonuseve është e parapar me harta zonale, e kemi pa të arsyeshme se një rregullore e tillë ja lehtëson punën Komunës, po ashtu për procedura të tej zgjatura për me arrit marrëveshjen bashkë me investitorin, ajo qka nuk më pëlqej mbrenda kësaj rregullore është që po jepet një opsion për me u zvoglu vija ndërtimore, a është e domosdoshme zvogëlimi I vijës ndërtimore për me u realiyu këmbimi I bonus ndërtimit edhe a zvoglohen distancat ndaj fqinjëve sa I përket largësis së objektit në momentin që I lejohet bonus ndërtimi.

Visar Kuqi-Tek vija ndërtimore edhe ne e kemi pas si shqetësim përshkak mos me e prishë renditjen, maksimumi 30% I 8 metershit. Qka kemi mujt ne me nxjerr dhe zyrtarët e urbanizmit këtë formul me kalkulu maksimumi 25% me 10% që dmth qdo here me I ra 10% I vijës ndërtimore, veq kur e kem shpronësimin 25% shkon 10% e vijës ndërtimore. Në 8 metra-20m lartësi e shfrytëzojnë vijën ndërtimore duke rrspektu hapin e 2.5gjithnjë edhe unë e kam cek edhe zyrtarët edhe tek vija ndërtimore kemi me e provu me rritë te 20m me shku atë shkallëzimin prej bazës maksimumi edhe shfrytëzueshmëria e sipërfaqes. Në raste të rrallë e shfrytëzojnë investitorët komplet koeficientin.

Sanije Kuqi Rexhepaj-Në kushtet që I kanë dhe si e tha edhe Drejtori rrallë here shfrytëzohet maksimumi, përshkak se nuk është tu u ndertu një kompleks, por është tu u ndertu pjesë pjesë. Nuk është që synohet me marrë një hapsirë shumë të madhe për me e shfrytëzu maksimumin që lejohet me hartë zonale dhe maksimumin tashë me e nxerrë përmesë rregullores. Unë po e kuptoj edhe këtë pjesë që në momentin ti e merrë një pjesë tokë ti duhesh me dhanë edhe 10% ndoshta edhe me shumë shfrytëzueshmëri të shputës, ti ke me u rritë dika për këtë pyetje ime ke A cenohen distancat nga fqinjët, në këtë rast po cenohet distanca nga rruga, në momentin që shputa ka me u rritë, nga ka me u rritë sipas juve, nëse nga fqinjët cenohet distanca, nëse nga rruga po cenohet vija ndërtimore.

Visar Kuqi-gjithmonë duke u respektu këndi 45°. Për atë ne e kemi kërku gjithmonë që në Komision të landës me qenë edhe zyrtari landës për arsye që e dine rastin.

Avni Bytyqi-Vija ndërtimore nuk ka me u rreziku asnjëherë, pamvarësisht prej asaj qka parasheh kjo rregullore nëse I referohemi nenit 15 mes ligjëve dhe aktëve ligjore që miratohen, nëse kjo rregullore është në kundërshtim me hartën zonale dhe është në kundërshtim me udhëzimin për norma teknike atëherë vjen në shprehje harta dhe udhëzimi administrative. Asnjëherë nuk guxojna me ja cenu kërkuja të drejtën për me realizu një qëllim të vetin. Te procedura e aplikimit nuk është e lehtë edhe për investitorin nëse interesohet apo ka interes me apliku, e ka një vargë dokumentash që ka me plotësu paraprakisht para se me apliku, Komisioni ka me e shqyrtu bashkë me ekspertin e licencum nga jashtë për vlerësimin se sa ka vlerë ajo tokë dhe sa I takon me kompenzu, idea ime ka qenë me kan eksperti I licencum nga jashtë për qëllim s është I vetmi organ që ka të drejtë nënshkrimi për vlerësimin e pronës.

Sanije Kuqi Rexhepaj-sa duhet mu të bë vlerësimi I kësaj prone në kosto. A duhet vlerësimi me Euro?

Avni Bytyqi-Sa ka vlerë ajo tokë sipas vlerës së pronës që e caktonë eksperti.

Visar Kuqi-Ne fillimisht i kemi futë të gjitha zonat në bonus por pas konsultimit me Ministrin, Ministria na ka imponu këtë zonë nuk ke të drejtë ike të shfrytëzuar dhe neve na ka leju vetëm në Zp3 ZP 4 ZP5

ZSHP3 ZSHP4 ZSHP5 dhe vetëm në këto zona lejohet bonusi.Dhe e kemi cekë nëse investitori i plotëson kushtet maksimumi investitori ka të drejtë edhe një kat me e shtu +edhe një kat të tërhekur.

Sanije Kuqi Rexhepaj-Nëse kjo është parcela dhe po meret një zonë për ndërtim të rrugës tash kur kalkulohet koeficienti psh është Zp 4 bëhet me 2.5 maksimalja e rritur është 4,ky 4 a llogaritet komplet për këtë parcelen apo vetëm për pjesen e marrur.

Visar Kuqi-Zp 4 nëse e ka koeficientin 2,5 kemi shku koeficientin bazë 2.5 të asaj parcele kadastrale e kalkulojmë koeficientin që i bie në 1000m 2500m baza dhe ne koeficientin e japim vetëm për 200m por jo ekstra.

Sanije Kuqi Rexhepaj- 2.5 a llogaritet për parcelën ndërtimore apo për parcelën kadastrale?

Visar Kuqi-për parcelën kadastrale.

Sanijee Kuqi Rexhepaj-Për mendimin tim Kryesues normalisht kjo rregullorë është e mirpritur por është dashtë mr u mbajtë edhe një konsultim publik ndoshta nuk është obligim ligjor por do qështje kjo fushë është kogja shumë e koklavitëne për dikën që nuk punon në këtë fushë,psh pytjet që i bën kolegtë jan shumë me vend dhe jan paqartësi shumë me vend.Dhe për këtë arsye është dashtë me u mbajtë një prezantim publik që të paktën me pas të qartë se qka është sepse me një lexim nëse nuk je professioniste nuk mundet me marrë vesh kurgjo.Eshtë dashtë këto sene me u prrezantu me një slajd me një rast konkret që me e kuptu të paktën se për qka o k bëhet fjale,me qenëse nuk është mbajt nje prezantim publik mbrenda shqyrtimitmpublik të paktën Drejtorë në Asamble me na ardhë me një prrezantim është e mirpritur.

Avni Bytyqi-vetëm dhe një dispozitë që ke diskutabile për Urimin neni 16,objektet të cilat jan ndërtu nga momenti kur kan marrë leje me hartë zonale e deri kur të miratohet kjo rregullore,me pas të drejtën me arsyetu për arsye se është faji jonë që nuk e kemi bë rregulloren deri sotë nuk është faji investitori që dmth ja kemi mohu një të drejtë qe i takon me hartë zonale.

Liridon Fondaj-jashtë kësaj rregullore a lejohet me ndërtu jashtë planit zhvillimor dhe hartës zonale ?

Visar Kuqi-Jo

Liridon Fondaj-stëherë qysh po lejohet kur Ministria na ka kthi dhe ne po ndërtojmë Xhami në Shirokë?

Visar Kuqi-Atëherë nuk ka qenë një dokumnet i kërkun prrej drejtorisë së Urbanizmit,por është kthi për arsye që nuk kaqenë landa e kompletune.

Urim Suka- e para ka disa gabime që janë fjal të ngjitura ,qështje teknike, dyta e tha edhe Sanija si kjo rregullore që është edhe nëse me ligj nuk na takon me u pas mbajtë një prezantim publik sot nuk kishim pas nevojë për debat por vetëm kishim votu,për situtat të tilla kur rregulloret jan shumë profesionale që Asambleistat nuk kuptojn ndoshta është mir me organzu naj tem diskutimi që ti i informon paraprakisht për atë rregullore dhe dikush ka ndonje ide dhe ta jep aty për aty shterret debati dhe ne kur vimë këtu janë punët e kryme për të ardhmen jo për sotë.

Kryesuesi- e hedhë në votim

4vota për,1Kundër,2Abstenime

Pika 3:Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajjtshme

Kryesuesi-laboron këtë pikë dhe hapë debatin

Liridon Fondaj-pjesën e shëndrrimit qka përfiton Komuna,sepse këtu po shkruan që poseduesi i njësis kadastrale në bazë të drejtave pronësore juridike i takojnë jo më pak se 20% ndërtimit neto,a ka mu formu Komision tjetër për ndarjen e ketyre?

Avni Bytyqi-Ajo ka qenë nga thirrja publike apo konkurimi i hapur ka qenë minimumi 20% ndërsa e ka fitu me 21%.Formohet Komisioni 2 prej Asambles 2 prej Ekzekutivit 1 nga shoqëria civile.Në shfrytëzim aatgjatë dhe afatshkurtë dallon,te dhënja afatgjate përgjegjësia bjen mbi Kuvendin seepse Kuvendi miraton,te afatshkurta përgjegjësia bjen mbi Komisioni.

Liridon Fondaj-Ky Komision këtë raport që na ka pru neve duhet me naj dhën edhe disa mostra se në bazë qka ka vendos me ja dhën 21%,në bazë të kontrates se fundit,se nëse kemi investitor që kan marrë

me 30% apo 31% dhe ne pronën e Komunës me e dhën me 21%.Nuk ka në Suharekë asnje vend që e jep najkush me 21% dhe ne pronën komunale me e dhën të paktën me ju referu të fundit.

Urim Suka-kur po na vijnë qto raporte te Komisioneve po kam qef me figuru edhe emrat e anëtarëve të Komisionit,se nëse kam ndonjë paqartësi mundem me i kontaku dhe me u sqaru psh.dhe unë po mendojë që është mirë me qenë emrat.

Avni Bytyqi-secili raport duhet me pasë Emrin e anëtarëve te Komisionit.

Urim Suka-kur po na vijnë kto land sidomos pe kem proble me identifiku se për cilen parcel po bëhet fjalë,se di a kish pas mundësi në kllapa me u shënu psh si tash Te Meha, për me u identifiku më lehtë.

Te Meha më dukët që është edhe një parcelë tjetër që është kan trekëndësh,ajo që mu po me intereson unë te Meha kam pa që po ndërtohet dhe ne ende skemi marrë vendim,a është veq ajo apo aty.

Avni Bytyqi-te Meha kan me u ndërtu 4 llamella dhe është tu u punu në llamella tjera jo te kjo që ne kemi me marrë vendim.

Dardan Berisha-ky raport është i seancës së kaluar dhe mu më duket shumë banale dhe me politizu këtë qështje se Urimiështë i informun që Kushtrimi ka aqenë pjesë e Komisionit,dhe nuk është në rregull për dy rreshta që nuk i ka shkru komisioni nuk mundemi me ja hudhë poshtë krejtë punen.

Kryesusei-e hedhë në votim

4 për,3 kundër dërgohet në asamble

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin vlerës së bonus banimit;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha-dhe këtu është dashtë me shënu se kush ka përfitu,pse se keni bashkangjitë raportin .

Urim Suka-në faktë unë e pata këtë shqetësim që e ngriti Dardani,uroj për vitin paraprak është mir me na ardhë një raport se qka ka ndodhë në vitine kalumme këtë projekt,kush ka përfitu .

Avni Bytyqi-vlëra e çmimit e qdo seni në Kosovë është e lirë dhe duhet me marrë monstra,vlerën e qmimit të qeras 50% e subvencionon Komuna.Dhe uk kryhet asnjë pa noter.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershor”;

Kryesuesi-laboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fondaj-ne e mbështesim këtë projekt-vendim se është njëri nder projekt-vendimeve që nuk na takon as me diskutu hiq,janë personalitete që e meritojnë,por tek pjesa e 13 Qershorit nëse jan themeluesit në pjesen e tyre ka qen edhe Bislim Zyrapi dhe Gafurr Elshani cila është arsyeja që nuk jan kanë marr mirënjohje ata apo qfarë.

Kryesuesi-e kemi diskutu që me bisedu edhe një herë me keta persona Bislim Zyrapi dhe Gafurr Elshani kan qenë pjesëmarrës në takim dhe kemi bisedu me ta,këta dy pikërisht kan qenë pjesëmarrës në takim dhe janë marrë vesh mes vete.

Dardan Berisha-me të vertetë është një projekt që nuk duhet as me u diskutu,unëpersonalisht du me qenë i kjartë këta dy që i permene ti kan qenë themelues te Brigadës 123 apo të Zonës Operative të Pashtrikutt.

Kryesuesi-e Brigadës 123.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht Miratohet

Pika 6.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-18942;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka-mu ka dokë e pazakontë edhe te arsyetimi Ministrisë.

Avni Bytyqi-shabllon e kan ata këtë arsyetim.
Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht Miratohet

Pika 7.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesa 01-Nr-553-27510;

Kryesuesi-laboron pikën.
Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi:14:35